

VENDIM
Nr.37, datë 23.8.2005

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT

Në mbështetje të nenit 9, nenit 13 pika 1, geramat ç dhe dh, nenit 15 pika 1 dhe nenit 45 pika 2 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s,” me ndryshimet përkatëse, neni 11; Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 23.8.2005, pasi shqyrtoi aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga shoqëria KESH sh.a. për vitin 2006; aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga shoqëria “Favina” sh.p.k.,

VENDOSI :

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga shoqëria KESH sh.a. për vitin 2006.
 2. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga shoqëria “Favina” sh.p.k.
 3. Ngarkohet Departamenti i Tarifave dhe i Çmimeve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema